



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Prishtinë, më 21 prill 2020

UDHËZIME PËR PËRMBARUES PRIVAT

Bazuar në situatën aktuale lidhur me *pandeminë Covid 19* si dhe në vijim të udhëzimeve të ofruara në muajin mars, Ministria e Drejtësisë ofron udhëzime si më poshtë:

Për shkak të situatës së rënduar nga *pandemia COVID - 19*, si dhe për shkak të reduktimit të stafit në institucione, banka, zyra përmbarimore si dhe për shkak të nevojave në rritje të qytetarëve për furnizime me gjëra të domosdoshme për ekzistencë, Ministria e Drejtësisë, udhëzon përmbaruesit, që t'i lejojnë qytetarët të marrin pensionet dhe pagat për muajin Prill dhe Maj 2020, pra të mos i debitojnë këto pagesa për interes të lëndëve përmbarimore për shkak të situatës në të cilën ndodhemi.



Albulena HAXHIU

Ministër në detyrë e Drejtësisë